


Shërbimet të Shencës  
Plenare



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Kuvendi



Nr. Prot 3300

Tiranë, 30.08. 2024

Lenda: Kërkesë për interpelancë me ministren e Turizmit dhe Mjedisit, Znj Mirela Kumbaro

Drejtuar: Znj. Elisa Spiropali

Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

E nderuar zonja Kryetare,

Bazuar në nenin 80, pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 96 të Rregullores së Kuvendit, kërkoj interpelancë me ministren e Turizmit dhe Mjedisit, Znj Mirela Kumbaro në lidhje me monitorimin e ngarkesave me lëndë helmuese që transportohen nga Shqipëria.

1. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka licensuar në vitin 2022 të vetmen kompani SOKOLAJ SHPK që mundëson "transportim i mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme". Cila ishte arsyeja e kësaj license?

2. Duke qënë kompania e vetme që mund të transportonte mbetje të rrezikshme, a e kemi monitoruar dhe inspektuar aktivitetin e saj?
3. A keni një raport inspektimi, që është detyrim ligjor, për çdo ngarkesë që ka hyrë e ka dale në Shqipëri?

Mbetem në pritje të caktimit të datës së interpelancës në përputhje me afatet e përcaktuara në Kushtetutën e Shqipërisë dhe Rregulloren e Kuvendit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

Deputeti

Agron Shehaj

